



RTK 1
Mentor SHALA
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/13
Ref:1807/800/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/13 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për RTK 1 (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 12 shkurt 2018 ka pranuar një ankesë nga z. Vesel Ismajli ndaj Palës Përgjegjëse për emisionin “Betimi për drejtësi” të transmetuar me datën 24 janar 2018, përmes së cilës z. Ismajli pretendon se Pala Përgjegjëse përmes këtij emisioni i ka cenuar të drejtat individuale, duke raportuar përmbajtje programore të pasakta dhe lajme jo të vërteta, qasje të njëanshme, mos dallimit ndërmjet lajmit dhe opinionit dhe shprehjeve jo adekuate e denigruese me qëllim të denigrimit të personalitetit të tij. Po ashtu z. Ismajli ka kërkuar edhe përmirësimin e shprehjeve në lajm dhe heqjen e lajmit.
3. KPM me datën 12 shkurt 2018 nëpërmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga z. Ismajli dhe ka kërkuar sqarim lidhur me pretendimet e ankesës në fjalë.
4. KPM me datën 20 shkurt 2018 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës i mohon si të paqëndrueshme pretendimet e z. Ismajli.
5. KPM ka analizuar ankesën e z. Ismajli, përgjigjen e Palës Përgjegjëse, dhe të gjeturat e monitorimit datës 22 shkurt 2018, dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

Analiza Ligjore

6. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse nuk është gjetur në shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. Komisioni i KPM-së pretendimet e Palës Ankuese i ka trajtuar në bazë të neneve të cekura në ankesë, në kuptimin e nenit 5 paragrafi 3 dhe nenit 6, paragrafi 1, 2, 4, 7 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 5 paragrafi 3 përcakton se:

“OSHM-të gjatë transmetimit të përmbajtjes nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi në bazë të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, gjendjes martesore, moshës apo paafhtësisë fizike ose mendore.”

Komisioni i KPM-së gjatë monitorimit ka gjetur se Pala Ankuese duke u referuar në këtë nen pretendon se shprehja *“betejës me gjykatës që akuzohen si uzurpator”* përbën gjuhë denigruese dhe që nxitë urrejtje ndaj tij, mirëpo gazetari asnjëherë gjatë emisionit nuk iu ka referuar si gjykatës uzurpator pa e potencuar se palët e tjera në këtë kontest po i referohen si i tillë.

Neni 6, paragrafi 1 përcakton se:

“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t'i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues.”

Komisioni i KPM-së ka gjetur se as pretendimi i Palës Ankuese për raportim të anshëm nuk qëndron sepse Pala Ankuese ka qenë e intervistuar dhe iu kanë bërë të ditura të gjitha akuzat e palëve të tjera dhe është përgjigjur rreth tyre.

Neni 6 paragrafi 2 përcakton se:

“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërthënies politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ.”

Komisioni i KPM-së ka gjetur edhe se emisioni ka qenë mirë i balancuar sepse janë konsultuar burime të arsyeshme në lidhje me këtë rast, duke filluar nga Komuna e Prishtinës, avokatët mbrojtës të palëve, të gjitha palët e përfshira në kontest rreth kësaj toke dhe nuk është vërejtur të jetë privilegjuar ndonjë palë në ndonjë mënyrë, kjo pasi që të gjithë kanë paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tyre.

Neni 6 paragrafi 4 përcakton se:

“Përderisa OSHM-të janë të lirë për të shprehur opinionet e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinionit mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese.”

Komisioni i KPM-së nuk e ka gjetur në shkelje Palën Përgjegjëse edhe sa i përket këtij neni pasi që në emision dhe në veçanti në intervistën e realizuar me palën ankuese, gazetari i referohet saktë gjatë trajtimit të temës duke e cilësuar atë si të akuzuar nga palët e caktuara dhe jo nga gjykata, siç pretendon pala ankuese.

Neni 6 paragrafi 7 përcakton se:

“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim.”

Komisioni i KPM-së gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në pajtim me nenin 6, paragrafi 7 pasi që gazetari i ka ofruar mundësinë të gjitha palëve për ofrimin e perspektivës/qëndrimit të tyre përmes intervistave dhe nuk është vërejtur asnjë anim ose favorizim të ndonjërës palë.

8. Komisioni i KPM-së ka analizuar edhe përgjigjen e Palës Përgjegjëse e cila ofron sqarime të mjaftueshme dhe të hollësishme, të cilat u vërtetuan edhe me monitorimin e bërë nga Zyra Ekzekutive.
9. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjeturat e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KPM-2016/03 gjatë transmetimit të emisionit “Betimi për drejtësi”.
10. Prandaj, Komisioni i KPM-së duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, gjen se Pala Përgjegjëse, kundër të cilës është ankuar z. Vesel Ismajli, është në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KPM-2016/03.

Vendimi

11. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.
12. Komisioni i KPM-së ankesën e Palës Ankuese përmes së cilës pretendohet se Pala Përgjegjëse i ka cenuar të drejtat individuale me qëllim të denigrimit të personalitetit të tij, e refuzon si të pabazuar.

E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



10.07.2018
Datë